

REPUBLIKA E SHQIPRIE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 3345 REP.

NR. 534 KOL.



KONTRATE PER
DHURIM KUOTASH

Sot, me date 15/12/2017 (detyruesisht në ditën e Pushtimit), perpara meje, Noteres publike **Donika A. Gjini**, anetar i Dhomes se Notereve Tirane, me zyre ne adresen: Blv.Bajram Curri, Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme per te lidhur kete Kontrate per Dhurim Kuotash (me poshte referuar si "Kontrata"):

Z. Gazmend Metohu, shtetas shqiptar, atesia Ymer, lindur me 07.03.1963, ne Tirane, Shqiperi, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numer 029497902, dhe me nr. personal G30307140S ("Dhuruesi");

Zj.Enkelejda Metohu, atesia Hazi, dtl 27.04.1970 lindur dhe banuese ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr. 024658910 dhe nr personal H054270548, ne cilesine e bashkeshortes se Dhuruesit, dhenese e pelqimit ne kete kontrate dhurimi kuotash.

dhe

Z.Gentjan SULA, shtetas shqiptar, atesia Astrit, lindur me 29.07.1970, ne Tirane, Shqiperi, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numer 027210813, dhe me nr. personal H00729093H ("Pranuesi i Dhurimit").

Ne vijim referuar se bashku si "Palet" dhe veçmas si "Pala".

MEQENESE:

(A) Dhuruesi eshte ortak i vetem i shoqerise "MET-ENGINEERING" Sh.p.k., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin e saj sipas te drejtes shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ("QKB") me Numer Unik Identifikimi te Subjektit ("NUIS") L52025007R, me seli ne adresen: Tirane, Rruga Unaza e Re, Godine banimi dhe Sherbimi, Njesia II.04, me kapital 10,000 Lek (dhjete mije leke) ("Shoqeria");

(B) Shoqeria kryen aktivitet ne perputhje me Statutin e saj.

(C) ~~Dhuruesi~~ Deklaron se ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate shoqeria funksion normalisht dhe ajo nuk eshte as ne gjendje falimentimi e as likuidimi;

- (D) Eshte mbledhur Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoqerise "MET-ENGINEERING" sh.p.k ne te cilen eshte rene dakort dhurimi i 100% te kuotave Z. Gentjan Sula;
- (E) Dhuruesi deshiron t'i dhuroje Pranuesit te Dhurimit (*sipas parashikimeve te Kodit te Familjes, neni 77, pika b*), *personalisht Pranuesit te Dhurimit dhe jo bashkesise familjare*) 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise, dhe ky i fundit pranon nga Dhuruesi 100% te kapitalit te Shoqerise ne perputhje me kushtet e Kontrates.

SA ME SIPER, Palet bien dakord per sa me poshte vijon:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Dhuruesi pranon t'i dhuroje Bleresit 100 % te kapitalit te Shoqerise, me vlere nominale 10,000 (dhjete mije) Leke ("Kuota e Pranuesit te Dhurimit").
- 1.2 Pranuesi i Dhurimit pranon dhurimin nga Dhuruesi te 100 % te Kapitalit qe Dhuruesi zoteron ne shoqerine MET-ENGINEERING shpk. Pas ketij transferimi Pranuesi i Dhurimit Z.Gentjan SULA do te zoteroje 100% te kapitalit te Shoqerise MET-ENGINEERING sh.p.k. qe perfaqeson 1 (nje) Kuote.

Neni 2


Transferimi i Kuotave

- 2.1 E drejta e pronesise se Dhuruesit mbi Kuoten e Pranuesit te Dhurimit do te transferohet ne favor te Pranuesit te Dhurimit me nenshkrimin e Kontrates.
- 2.2 Dhuruesi do t'i dorezoje Pranuesit te Dhurimit te gjithë dokumentet, deklaratat ose çertifikatat e nevojshme per permbushjen e transferimit te Kuotes ne favor te Pranuesit te Dhurimit .
- 2.3 Me transferimin e Kuotes ne pronesi te Pranuesit te Dhurimit Ortaku i Vetem i Shoqerise do te jete perkatesisht Z. Gentjan Sula, zoterues i 1 (nje) Kuote, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te Shoqerise.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci

- 4.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesit te Dhurimit per sa me poshte vijon:
- 4.1.1 Dhuruesi eshte pronari i vetem i Kuotes se Pranuesit te Dhurimit dhe te drejtave qe rrjedhin prej saj sikurse vertetohet nga ekstrakti i leshuar nga QKB, bashkengjitur Kontrates, dhe se nuk ka ndonje pretendim nga ndonje pale e trete ndaj te drejtes se pronesise mbi Kuoten se Pranuesit te Dhurimit, ekzistues apo te mundshem, i cili mund te kete efekt material negativ ne te drejten e pronesise mbi Kuoten e Pranuesit te Dhurimit.
- 4.1.2 Dhuruesi nuk eshte ne mospermbushje te ndonje marreveshje ne te cilen eshte pale, e cila mund te kete efekt material negative ne te drejten e pronesise mbi Kuote.
- 4.1.3 Kuota nuk eshte objekt te ndonje kufizimi dhe se eshte e lire nga cdo peng, privilegj, barre, apo cdo e drejte tjeter ne favor te te treteve.




- 4.1.4 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe në çfarëdo momenti tjetër të mëtejshëm pas lidhjes së saj, Dhuruesi I garanton Pranuesit të Dhurimit akses – prane selise së Shoqërisë – në origjinalet e librave kontabel të Shoqërisë dhe çdo dokumenti tjetër që aktualisht është në dispozicion/pronesi të Shoqërisë, ose që duhet apo do të jete me pas në dispozicion/pronesi të saj.
- 4.1.5 Dhuruesi deklaron dhe garanton se Shoqëria është themeluar dhe operon rregullisht në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në baze të ligjit dhe të akteve të Shoqërisë dhe ka të drejtë të ushtroje aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutit që rregullon funksionimin e saj.
- 4.1.6 Dhuruesi deklaron dhe garanton se Shoqëria nuk është në proces falimentimi dhe likuidimi të vullnetshëm ose jo, apo në ndonjë proces të ngjashëm.

- 4.2 Secila pale deklaron dhe garanton palen tjetër se kanë zotësi për të nënshkruar dhe përmbushur Kontraten dhe kushtet e parashikuara në këtë Kontratë janë të detyrueshme për to.

Neni 5

Dispozita të Pergjithshme

- 5.1 Mos ekzekutimi nga ndonjëra prej Paleve të ndonjë të drejtë lidhur me Kontraten, nuk do të konsiderohet në asnjë rast si heqje dore nga kjo e drejtë. Në asnjë rast veprimet apo mosveprimet e ndonjeres prej Paleve nuk do të përbejnë heqje dore nga kjo Pale nga të drejtat e lindura nga shkelja e Kontraten në teresi apo të ndonjë dispozite të Kontrates në veçanti nga Pala tjetër, me përjashtim të rastit kur Pala heq dore në mënyrë të shprehur me shkrim. Në rast se ndonjë Pale heq dore nga të drejtat e lindura nga shkelja e ndonjë dispozite të Kontrates prej Pales tjetër, në një apo me shumë raste, nuk do të përbejë apo konsiderohet si heqje dore nga të drejtat e saj në rast të shkeljes së mëpasshme të po të njëjtes dispozite, apo si heqje dore nga zbatimi i dispozites së shkelur.
- 5.2 Kontrata është hartuar dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- 5.3 Çdo mosmarreveshje që mund të lindi midis Paleve në lidhje me Kontraten do të zgjidhet miqësisht nga Palet, në të kundërt zgjidhja e mosmarreveshjes do të jete në kompetencën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë.
- 5.4 Kontrata përben marreveshjen e plotë midis Paleve në lidhje me objektin e saj dhe ka përparësi mbi çdo marreveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim, midis Paleve.
- 5.5 Kontrata nuk do të ndryshohet, zevendesohet apo shfuqizohet, përveçse me shkrim dhe të nënshkruar nga të dy Palet.
- 5.6 Në rast se ndonjë nga dispozitat e Kontrates është apo shpallet e pavlefshme apo e pazbatueshme, kjo pavlefshmeri apo pazbatueshmeri nuk do të cenojë vlefshmerinë apo zbatueshmerinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zevendesohet me një dispozite të vlefshme dhe të zbatueshme qëllimi i të cilit i përafrohet sa më shumë të jete e mundur synimeve të Paleve.



5.7 Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis Paleve do te behen me shkrim dhe do te konsiderohen si te dorezuara rregullisht nese i dorezohen dorazi me protokoll, me poste te regjistruar, Pales ne adresen e percaktuar me siper.

5.8 Kontrata eshte nenshkruar ne 4 (kater) kopje origjinale ne Shqip me te njejten vlere secila.

5.9 Te gjitha dokumentet qe do te dorezohen dhe komunikimet qe do te jepen ne baze te Kontrates do te jene ne shqip.

Ne kete kontrate ^{Gentjan Sula}dhurimi kuotash te shoqerise "MET-ENGINEERING" shpk, jep miratimin dhe nenshkruan me vullnet te lire dhe te plote edhe bashkeshortja e Dhuruesit Znj. Enkelejda Metohu, e cila shprehet plotesisht dakort me dhurimin e shoqerise si me siper dhe me gjithcka eshte parashikuar ne kete kontrate dhe nenshkruan rregullisht para noterit.

Une, Noterja anetare e Dhomes se Notereve Tirane, ua lexova me ze te larte tekstin e Kontrates, Paleve me siper, te cilat pasi u njohen me permbajtjen e saj deklarojne se ky dokument eshte ne perputhje me vullnetin e tyre te plote dhe te lire, dhe e nenshkruajne ate ne pranine time dhe une, Noteri, e vertetoj kete Kontrate sipas ligjit shqiptar

DHURUES

Z. Gazmend METOHU

DHENESE PELQIMI

Znj. Enkelejda METOHU

PRANUES I DHURIMIT

Z. Gentjan SULA

NOTER

Donika A. GJINI

